



Datë: 31.07.2025

Numër Protokolli: 5192/2025

A.nr.1108/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1108/2025 të datës 10.06.2025, të parashtruar nga ankuesi L.S, kundër Vendimit Nr.02/60 të datës 29.05.2025, të Kryeministrit në detyrë të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1108/2025, e datës 10.06.2025, e parashtruar nga ankuesi L.S.

A r s y e t i m

Ankuesi L.S (në *tekstin mëtejme referuar*: ankuesi), më datë 10.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.02/60 të datës 29.05.2025, të Kryeministrit në detyrë të Republikës së Kosovës, lidhur me emërimin e kandidatës fituese në pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese “Drejtor Ekzekutiv” në Agjencinë për Arsim Profesional dhe Arsim për të Rritur-Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në *tekstin e mëtejme referuar*: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi me date 10.06.2025, **është e palejuar**, sepse:

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës A.nr.371/2025, ka gjetur se Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, më datë 17.10.2024 ka shpallë Konkursin me numër reference RN00015112, për pozitën e punës “Drejtor Ekzekutiv” në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin për të Rritur, ku afati për aplikim ka qenë nga data 18.10.2024 deri më 16.11.2024.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës, rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë tetëmbëdhjetë (18) kandidatë, ndërsa prej tyre kriteret i kanë plotësuar dhe kanë vazhduar me fazat e vlerësimit profesional shtatë (7) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi i cili i është nënshtruar vlerësimit të testit me shkrim dhe intervistës me gojë ku ka arritur gjithsejtë 79 pikë të përgjithshme nga kjo procedurë rekrutimi.

Divizioni i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me datë 20.12.2024 ka nxjerrë Njoftimin lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve për pozitën e punës “Drejtor Ekzekutiv” në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin për të Rritur, i cili edhe është publikuar në SIMBNJ më datë 23.12.2024, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja F.Z, me gjithsejtë 92 pikë (45.8 nga testi me shkrim dhe 46.2 nga intervista me gojë) pikë të arritura, është renditur si kandidatja fituese me më së shumti pikë të arritura, para ankuesit i cili ka arritur gjithsejtë 79.4 pikë të përgjithshme (34.8 nga testi me shkrim dhe 44.6 nga intervista me gojë) dhe kandidatit tjetër fitues E.G i cili ka arritur gjithsejtë 70.2 pikë të përgjithshme nga kjo procedurë rekrutimi (29.8 nga testi me shkrim dhe 40.4 nga intervista me gojë).

Ankuesi, në ankesën e parashtruar me datë 26.02.2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendonte se është diskriminuar kundrejt kandidatëve tjerë ngase sipas tij ftesa për intervistë i është dërguar një ditë pas kandidatëve tjerë, duke deklaruar ndër të tjera se nuk i është lejuar qasja në testin me shkrim si dhe ka theksuar se kandidatja e parë në listë me më pas se dy vite del në pension ndërsa njoftimi është shpallur në SIMBNJ më datë 30.01.2025.

Ndërsa, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, me Vendimin A.nr.371/2025 të datës 14.04.2025, kishte konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 26.02.2025, është e pasafatshme sepse e njëjta ishte parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 47 paragrafi 10 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, neni 17 i Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil si dhe neni 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht e njëjta ishte e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Tutje, Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2025 të Qeverisë së Republikës së Kosovës në detyrë, ka nxjerrë Vendimin Nr.02/60, përmes të cilit akt kandidaten F.Z, e ka emëruar në pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese Drejtoresh Ekzekutive në Agjencinë për Arsim Profesional dhe Arsim për të Rritur-Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Ankuesi, kundër Vendimit Nr.02/60 të datës 29.05.2025, të Kryeministrit në detyrë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me emërimin e kandidates fituese në pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese: Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë për Arsim Profesional dhe Arsim për të Rritur-Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me datë 10.06.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor të mbështetur mbi bazën ligjore se sipas Nenit 31 të Ligjit për Qeverinë (Nr.08/L-092), Qeveria në dorëheqje është e kufizuar në kompetencat e saj, përkatësisht nuk inicion procedura të reja për emërimë në pozita publike dhe nuk bën propozime si dhe nuk inicion emërimë të zyrtarëve të lartë. Ankuesi, po ashtu thekson se sipas nenit 28 paragrafit 1.1 të këtij ligji, mandati i Qeverisë përfundon me përfundimin e mandatit katër (4) vjeçar, që në rastin konkret është data 22.03.2025, andaj i njëjti kërkon shqyrtimin e ligjshmërisë së këtij vendimit, anulimin e këtij vendimi për emërim si të paautorizuar dhe ripërtëritjen e kësaj procedure rekrutimi.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publike të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 47 paragrafi 10 ku përcaktohet se: *10. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative., si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimin në*

Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*, nga rrjedhë se e drejta e ankimimit pas shpalljes së rezultateve përfundimtare i 'u është njohur të gjithë kandidatëve pjesëmarrës në procedurat e rekrutimit për pozitat e Kategorisë së Lartë Drejtuese në Shërbimin Civil të Kosovës, të cilën të drejtë ankuesi rezulton se e ka shfrytëzuar me ankesën e datës 26.02.2025, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 20.12.2024, të publikuar me datë 23.12.2024 në SIMBNJ, lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve për Konkursin me numër reference RN00015112, për pozitën e punës “Drejtor Ekzekutiv” në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin për të Rritur, rrjedhimisht për të cilën çështje Këshilli kishte vendosur me Vendimin A.nr.371/2025 të datës 14.04.2025.

Andaj, Kolegji i Këshillit, bazuar në nenin 49 paragrafin 1 dhe 2, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *1. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë me vendim të arsyetuar përzgjedh kandidaten/in fitues të propozuar sipas paragrafit 8. të nenit 47 brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditësh nga shpallja e fituesve. 2. Kandidatja/i i përzgjedhur, sipas paragrafit 1. të këtij neni, emërohet në detyrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës për institucionet e administratës shtetërore apo nga titullarja/i i institucionit për institucionin tjetër shtetëror;*, dhe duke marrë për bazë dispozitat e nenit 129 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji”*, si dhe nga përcaktimet e dhëna si më lartë të ligjit material, konstatoi se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 10.06.2025 është e papranueshme, pasi që ligji material të drejtën e ankimimit ua ka njohur palëve në procedurë vetëm kundër aktit-njoftimit për shpalljen e rezultateve të kandidatëve të suksesshëm, ndërsa në rrethanat e rastit konkret ankuesi tani më ka parashtruar ankesë kundër aktit për emërimin e njërit nga kandidatët e suksesshëm në procedurë, gjegjësisht në rrethanat e rasteve të tilla ankesat janë të palejuara pasi që me ligjin material nuk është përcaktuar ankesë kundër aktit për emërimin e kandidatit por vetëm kundër aktit, respektivisht njoftimit për kandidatët e suksesshëm.

Theksuar si më sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenit 129 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1108/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit L.S;
- Kryeministrit në detyrë të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqëses së Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.